

PROF. ITALO COSTANTE FORTINO NË NJË INTERVISTË PËR "SHEKULLIN"

Era e ndryshimeve tenton të përlejë identitetet lokale

Merita Bruçi

Prof. Italo Costante Fortino, studiues arbëresh me famë ndërkombëtare ka një jetë që punon për një kulturë të shkëputur prej pesë shekujsh nga Shqipëria.

Në një intervistë për "Shekullin": "Njeriu, mirëqenia e tij e brendshme, kultura e tij duhet të jenë në qendër të vëmendjes të përvojës njerëzore dhe jo biznesi dhe tregtia, megjithëse e dimë se edhe tregtia duhet, siç duhet edhe anglishtja."

"Italo Kostante Fortinos, arbëresh, studiues i gjuhës dhe letërsisë shqipe, shqiptar me famë ndërkombëtare për veprën e tij të gjerë dhe të larmishme në të mirë të Shqiptarisë. Në veçanti për vlerësimin e veprës së shkrimtarit spexanjot Xhusepe Anxhelo Noçiti dhe të eseistit dhe historianit Xhovani Laviola."

Me këto fjalë Kozenca i ka shprehur mirënjohjen Italo Kostante Fortinos, profesorit ordinar të gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin "L'Orientale" të Napolit. Në ndërrimin e vitit 2010, atij iu dha çmimi "Città di Spezzano Albanese" nga Bashkim Kulturor Arbëresh dhe Bashkia e Spexano Albanese-s.

Prof. Fortino, ç'do të thotë për ju ky çmim që ju është dhënë së fundmi?

E konsideroj i një nder që më bëhet. Vlerësoj se të ndihmohet në nxjerrjen në pah të kulturës arbëreshe do të thotë të ngresh problemin e mbrojtjes së "vërtetë" të një kulture, të pasur e të çmueshme, siç është jona, arbëreshe, që prej më se pesë shekujsh mbetet ende e gjallë e pjellore.

Ky çmim ka meritën se shquan personalitete që me përkushtim punojnë në të mirë të komunitetit, me qëllim që të krijojnë një lëvizje mendimesh me synim forcimin e ndjenjës së identitetit kulturor dhe kompaktësinë e tij.

Mbrojtja "e vërtetë" bazohet në të dhëna objektive që parashikojnë nga njëra anë njohjen reale të gjendjes së kulturës, më anë tjetër përdorimin e mjeteve të duhura dhe efikase: që të dyja bashkëveprojnë për të forcuar dhe zhvilluar një kulturë, e cila përballë botës së globalizuar mund të rrezikojë të zhduket.

Të dhënat objektive duhet të ndiqen më pas nga marrja e masave të përshtatshme, në të mirë të një kulture minoritare në fazë dobësimi, duke pasur parasysh edhe atë që ka ndodhur e vërehet çdo ditë me kulturat e tjera që gjenden në të njëjtat kushte me atë arbëreshe.

Në një vështrim më të thelluar, kjo mbrojtje është ngushtësisht e lidhur me ekzistencën e kulturës arbëreshe, vlerën e çmuar që ka ajo sot, e jo vetëm atë historike, të së shkuarës, por ende të vlefshme edhe në këtë botë të globalizuar që kërkon të fshijë mospërfillshëm atë që konsiderohet jo prodhuese e jo e kënaqshme nga pikëpamja komerciale.

Marrin jetë, me fjalë të tjera, vlerat në vetvete dhe jo vetëm ato funksionale. Njeriu, mirëqenia e tij e brendshme, kultura e tij duhet të jenë në qendër të vëmendjes të përvojës njerëzore dhe jo biznesi dhe tregtia, megjithëse e dimë se edhe tregtia duhet, siç duhet edhe anglishtja.

Çfarë objektivash keni arritur gjatë kërkimeve tuaja?

Së pari kam botuar e bërë të njohur disa vepra të rralla apo të pabotuara të letërsisë arbëreshe. Pas fazës romantike të rizgjimit kulturor të kulturës arbëreshe, u bë e ngutshme që të njiheshin veprat letrare për të shijuar estetikisht, dhe nëpërmjet leximit të thelluar të mund të mbërrishej në një gjykim kritik sa më objektiv.

Që në 1984 përgatita dhe nxora nga shtypi botimin kritik të veprës Gjella e Shën Mërisë së Virgjër të Jul Varibobës. Ky botim hedh baza të sigurt për një lexim të veprës në formën origjinale më të mundshme, nëpërmjet botimit kritik. Kjo i ka lejuar lexuesit të thjeshtë dhe atij të specializuar të lexojë me të gjitha garancitë shkencore një vepër mjaft lirike dhe me një kolorit krejt të veçantë.

Sot jam edhe më i kënaqur se vepra është ribotuar edhe në Shqipëri, për lexuesit përtej Adriatikut, me të njëjtën saktësi shkencore dhe me një veshje të bukur tipografike (Jul Variboba, Gjella e Shën Mëris Virgjër, Përgatitur nga Italo Costante Fortino, me kujdesin e Akademikut Jorgo Bullo, Visare të Letërsisë Shqiptare, Botimet Toena, Tiranë 2010).

Veprat e pabotuara të letërsisë shqipe kanë qenë nxitje për kërkimet e mia dhe më kanë ndihmuar të zbuloj një shkrimtar arbëresh të papërmendur në historinë e letërsisë shqipe: Xhuzepe Anxhelo Noçiti (Giuseppe Angelo Nociti 1832-1899), nga Spixana (Spezzano Albanese), nga i cili kam botuar deri tani himnet e tij (Rëmenxa t'arbresha / Rime albanesi, Brenner, Cosenza 1992) dhe poemthin kushtuar figurës së Skënderbeut (Ndihmja e Krojës, në "Giorgio Castriota Scanderbeg nella storia e nella letteratura", Atti del Convegno Internazionale, Napoli, 2007, ff. 153-194). Bëhet fjalë për një poet dhe studiues shumë interesant, si për venën e tij poetike, për procesin e ngritjes së gjuhës popullore në gjuhë të letërsisë, ashtu edhe për studimet gjuhësore që lidhen kryesisht me leksikografinë shqipe.

Lidhur me këtë të fundit, kam vënë në dukje disa aspekte të kontributit të tij për leksikografinë në një Konferencë Shkencore Ndërkombëtare kushtuar Kostandin Kristoforidhit (Elbasan 2002) në një kumtesë më titull Leksiku i K. Kristoforidhit në Fjalorin dorëshkrim të Xhuzepe Anxhelo Noçiti. Kam gjithashtu kënaqësinë të bëj të ditur që së

shpejti dorëzoi për shtyp veprën e Xh.A. Noçitit Vocabolario Albanese (Fjalor Shqip) që përmban 10.000 lema. Një personalitet me interesa dhe studime, si ai i Noçitit, nuk mund të mbetet i panjohur për botën kulturore dhe letrare shqiptare.

Gjithë në hullinë e botimit të dokumenteve të pabotuara të letërsisë shqipe përparojnë edhe punë që kanë të bëjnë me veprën e një autori të madh arbëresh të shekullit XIX: Frangjisk Anton Santori (Francesco Antonio Santori).

Publikimi i disa novelave në vargje (romanzetti) më kanë dhënë shtysën për të vënë në dukje risinë e krijimit të tij letrar: interesin e treguar për çështjet me karakter shoqëror dhe fillimet e letërsisë së angazhuar. Kështu botimi për herë të parë i Kalimereve (Brenner, Cosenza, 2004) dëshmon për rolin që komponenti fetar ka pasur në spiritualitetin bizantin të komuniteteve arbëreshe dhe në forcimin e identitetit kulturor.

Edhe nga këto pak shënime mund të kuptohet si kultura arbëreshe, nga periudha e pas Luftës së Dytë Botërore e deri më sot, vjen duke u forcuar në kërkimet shkencore, që më pas përhapen e shtrihen më tej duke përfshirë të gjithë komunitetin.

Cila është gjendja e gjuhës, e letërsisë dhe e kulturës arbëreshe sot?

Nëse e krahasojmë gjendjen aktuale të gjuhës së folur në komunitetet arbëreshe të Italisë Jugore, me të kaluarën, verifikohet një rënie statistikore e arbërishtfolësve, sidomos tek brezat e rinj.

Përcjellja e gjuhës së folur në gjirin e familjes dhe më gjerë në katund është dobësuar në favor të gjuhës italiane. Shpresohet për një rimarrje kur mësimi i arbërishtes në shkollë të jetë më energjik dhe i mirëorganizuar, në mënyrë që t'i paraprijë rënies së përçarjes së gjuhës, peshë të cilën më parë e mbante familja dhe komuniteti në një vështrim më të gjerë.

Ndërsa, krijimi letrar, që pas Luftës e deri më sot po jeton një stinë lulëzimi, me një numër autorësh që sa vjen e pasurohet. Krahas poetëve të njohur si Vorea Ujko, Dushko Vetmo, Zef Skiro di Maxho, po afirmohet edhe një plejadë zërash të rinj që shkruajnë si në poezi edhe në prozë. Është kuptimplotë fakti që ekziston edhe një revistë Jeta Arbëreshe ku prej dhjetë vitesh botohet tërësisht në shqip, ku shkruajnë si arbëreshë, në të folmet e tyre përkatëse ashtu edhe shqiptarë, në kodin standard, por mbi argumente që lidhen me arbëreshët.

Kujtoj këtu se në dhjetëvjeçarët e fundit rrethi i atyre që dinë të shkruajnë në të folmet e vet amtare, është zgjeruar. Kjo falë zgjimit në përgjithësi të interesit për kulturat minoritare që gjallojnë në territorin italian, dhe që konsiderohen gjithnjë e më shumë një pasuri e vërtetë kombëtare, ashtu edhe falë Ligjit 482, aprovuar nga Parlamenti italian më 1999 që mbron këto pakica.

Gjithsesi, me gjithë këtë zgjim të interesit, shëndeti i kulturës arbëreshe nuk është i mirë: presioni që ushtron kultura sunduese, ajo italiane, po e thith kulturën minoritare arbëreshe. Era e ndryshimeve dhe e kontakteve gjithnjë e më të shpejta ndërmjet elementit italian dhe atij arbëresh fryn me furi dhe tenton të përblajë identitetet lokale.

Na duket se gjendemi përballë dy fenomenesh të kundërta: i pari është një tendencë, privilegj i një elite intelektualësh, të pasionuarish që i kushtohen me angazhim e përkushtim evidentimit të kulturës amtare të fshatrave të ndryshme arbëreshe; i dyti përfaqësohet nga përparimi i madh i kulturës italiane që shkërmoq e gllabëron atë arbëreshe, që nuk zotëron mjetet e duhura për një zhvillim institucional, organik e sistematik.

Mpakja, zbehja e përcjelljes tradicionale të kulturës arbëreshe, që në të kaluarën bëhej nëpërmjet, familjes, sheshit të katundit o vetë komunitetit, nëse nuk parashikohet të zëvendësohet nga arsimimi në rrugë institucionale dhe i detyrueshëm, me të njëjtat prerogativa si kultura sunduese italiane, rrezikon një dobësim të vazhdueshëm deri në zhdukje.

A shihni perspektiva për gjuhën dhe kulturën arbëreshe?

Vështirësitë që po kalon gjuha dhe kultura arbëreshe përballë veprimit përthithës që ushtron gjuha dhe kultura italiane nisur nga një pozitë sunduese, janë të kuptueshme. Megjithatë, jam i bindur se mund të bëhet shumë me perspektiva pozitive që mund të garantojnë vazhdimësinë e tyre.

Rolin kryesor në këtë betejë duhet ta luajë shkolla, në mënyrë që kultura arbëreshe nga një kulturë analfabete të shndërrohet në një kulturë të shkruar nga të gjithë anëtarët e një komuniteti.

Sot ka një ligj për mbrojtjen e pakicave gjuhësore historike që jetojnë në territorin italian, por ky ligj duhet përmirësuar me qëllim që ta bëjë të detyrueshëm mësimin e gjuhës, letërsisë dhe kulturës arbëreshe në kuadër të arsimit të detyruar shkollor: kjo detyrë i takon shtetit italian të sigurojë që nxënësve t'u mësohet të shkruhet gjuha e prindërve të tyre. Po sjell një shembull: në 1867 nga 300.000 shtetas të popullsisë maore, në Zelandën e RE, vetëm ¼ përdorte të folmen e vet amtare, të gjithë të tjerët përdornin anglishten.

Me hapjen masive të shkollave ku mësohej e folmja e tyre, që nga "çerdhet e gjuhës" për më të vegjlit, e më pas me shkollën 9 vjeçare të ciklit të ulët e të lartë, në fund të shekullit u arrit një objektiv i kënaqshëm: pjesa më e madhe e popullsisë maore ishte e alfabetizuar në gjuhën dhe kulturën e saj. Sot në Zelandën e Re, gjuha maori është e vetmja gjuhë indigjene që vazhdon të flitet.

Një pikë tjetër e rëndësishme është përfshirja e vetë arbërishtfolësve në procesin e rigjallërimit të kulturës së vet. Kërkohet një ndërgjegjësim i familjeve dhe i tërë komunitetit, një angazhim spontan e bindës në të mirë të gjuhës amtare që sot është e kërcënuar.

Kjo përfshirje duhet të synojë si objektiv parësor të bindë komunitetin se të flasësh arbërisht nuk i dëmton asesi folësit, përkundrazi i privilegjon, sepse i rrit dhe i zhvillon në mënyrë harmonike me kulturën bazë dhe i lehtëson edhe në asimilimin e kodeve të tjera gjuhësore (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Një rol jo më pak të rëndësishëm në mbrojtjen e të folmeve të kërcënuara e luajnë gjuhëtarët, ose më gjerë studiuesit.

Ata kanë për detyrë t'i studiojnë shkencërisht këto të folme, arbëreshet në rastin tonë, të bëjnë përshkrimin e tyre dhe të hartojnë mjetet didaktike të nevojshme për të gjithë folësit. Është bërë një punë e mirë në këtë drejtim.

Po citoj disa tekste: La parlata albanese di Greci, hartuar nga M. Camaj (Firenze 1971), Arbërishtja për të gjithë me autor Giuseppe Schirò Di Modica (Piana Degli Albanesi 2005), Gramatikë arbëreshe me autor Emanuele Giordano (2005), dhe një manual shkollor në dy vëllime Alfabetizzazione arbëreshe (Ed. Il Capitello, Torino 2000), hartuar nga një grup studiuesish (C. Stamile, A. Giordano, V. Bruno, I. C. Fortino, E. Tocci, E. Giordano) me nxitjen e Shoqatës së Mësuesve Shqiptarëve të Italisë. Një fenomen interesant po vihet re këta vitet e fundit.

Arbërishtja, që deri dje konsiderohej si gjuhë e komunikimit familjar dhe popullor, sot përdoret, nga disa pionierë të kësaj nismeje, edhe në konferenca e tubime të ndryshme shkencore, apo në mbledhje më me përgjegjësi e të rëndësishme që mbahen në katundet arbëreshe. Kjo ndihmon t'i japë prestigj arbërishtes dhe e vë në provë që të shprehë koncepte abstrakte dhe të rëndësishme.

Në përfundim mund të them se nëse merren masa në drejtimet që tregova më lart, gjuha dhe kultura arbëreshe kanë perspektiva të mira që t'i rezistojnë rrezikut të zhdukjes dhe mundësi reale zhvillimi, sepse konsiderohen edhe një pasuri e vetë shtetit italian, pjesë përbërëse e të cilit janë.

Il Premio “Città di Spezzano Albanese” al Prof. Fortino a cura di Merita Bruci Sauku

Al Prof. I. C. Fortino, Ordinario di Lingua e Letteratura Albanese all'Università L'Orientale di Napoli, è stato conferito il Premio “Città di Spezzano Albanese” il 30 dicembre 2010, dall'Associazione “Bashkim Kulturor Arbëresh” e dall'Amministrazione Comunale di Spezzano Albanese (CS), con la seguente motivazione: “A Italo Costante Fortino, arbëresh, studioso della lingua e letteratura albanese, albanese di fama internazionale per la sua opera estesa e multiforme a favore dell'Albanesità. In particolare per la valorizzazione dell'opera del letterato spezzanese Giuseppe Angelo Nociti e del saggista-storico Giovanni Laviola”.

A lui abbiamo rivolto quattro domande.

Che significato ha avuto per lei il Premio “Città di Spezzano Albanese” assegnatole di recente?

Al di là dell'onore che mi è stato tributato col conferimento del suddetto Premio, di cui ringrazio profondamente l'Amministrazione comunale di Spezzano e in particolare l'Associazione “Bashkim Kulturor Arbëresh”, ritengo che il mio contributo alla valorizzazione della cultura arbëreshe sollevi il problema della “vera” tutela di una cultura, ricca e preziosa, com'è la nostra, l'arbëreshe, che da più di cinque secoli si è dimostrata vitale e produttiva. Questo Premio ha il merito di segnalare le personalità che con impegno lavorano a favore della comunità, con lo scopo di creare un movimento di opinione che rafforzi il senso dell'identità culturale e la compattezza della stessa comunità. La “vera” tutela si basa su dati obiettivi che prevedono da un lato la conoscenza reale dello stato della cultura, dall'altro il ricorso a strumenti adatti ed efficaci che concorrano a rafforzare e sviluppare una cultura che nel mondo globalizzato attuale potrebbe correre il rischio di scomparire. I dati obiettivi, poi, devono tendere a far prendere provvedimenti adeguati a favore di una cultura minoritaria che si trova in una fase di indebolimento, tenendo presente anche quanto è avvenuto e avviene per altre culture che si sono trovate o si trovino nelle stesse condizioni di quella arbëreshe.

Il significato profondo, dunque, è strettamente connesso con l'esistenza della cultura arbëreshe, la sua preziosità oggi, e non solo di quella storica del passato, e ancora valida in un mondo globalizzato che cerca di annullare in maniera sprezzante quanto ritenuto non produttivo e commercialmente non soddisfacente. Si ribadisce, in altri termini, il valore in sé e non solo quello di funzione. L'uomo, il suo benessere interiore, la sua cultura devono essere al centro dell'esperienza umana e non l'affare e il commercio, anche se, sappiamo bene che il commercio serve, come serve anche l'inglese.

Quali sono gli obiettivi raggiunti con la sua ricerca?

Il primo obiettivo raggiunto è stato quello di far conoscere, nella loro autenticità, alcune opere rare o inedite della letteratura arbëreshe. Dopo la fase romantica del risveglio della cultura arbëreshe, si rendeva urgente entrare nel merito delle opere per assaporarne il gusto estetico e, attraverso la lettura approfondita arrivare a un giudizio critico il più possibile obiettivo. Già nel 1984 la pubblicazione, a mia cura, dell'opera della *Gjella e Shën Mëris Virgjër* di Giulio Varibobba, poneva i presupposti sicuri per una lettura dell'opera nella forma più originale possibile, attraverso l'edizione critica. Ciò ha permesso al lettore comune e a quello specialistico di leggere con tutte le garanzie scientifiche un'opera altamente lirica con una sua coloritura del tutto particolare. Oggi sono anche più soddisfatto perché l'opera è stata pubblicata in Albania, in una seconda edizione, per i lettori d'oltre Adriatico, con lo stesso rigore scientifico e in bella veste tipografica (Jul Variboba, *Gjella e Shën Meris Virgjër*, Përgatitur nga Italo Costante Fortino, me kujdesin e Akademikut Jorgo Bulo, Visare të Letërsisë Shqiptare, Botimet Toena, Tiranë 2010). L'inedito della letteratura arbëreshe ha sollecitato le mie ricerche e mi ha fatto scoprire uno scrittore prima completamente assente nella storia della letteratura albanese: Giuseppe Angelo Nociti (1832-1899), di Spezzano Albanese (CS), di cui ho pubblicato finora i suoi inni (*Rëmenxa t'arbresha / Rime albanesi*, Brenner, Cosenza 1992) e il poemetto dedicato a Scanderbeg (*Ndihmja e Krojës*, in “Giorgio Castriota Scanderbeg nella storia e nella letteratura”, Atti del Convegno Internazionale, Napoli, 2007, pp. 153-194). Si tratta di un poeta e studioso molto interessante, sia per la sua vena poetica, sia per il processo di elevazione della lingua popolare a lingua della letteratura, sia anche per i suoi studi linguistici che abbracciano soprattutto la lessicografia albanese. Per quanto riguarda quest'ultimo aspetto ho avuto modo di far conoscere alcuni aspetti del suo contributo alla

lessicografia in occasione della Conferenza Scientifica Internazionale dedicata a Costantino Kristoforidhi (Elbasan 2002) con la relazione dal titolo: *Leksiku i K. Kristoforidhit në Fjalorin dorëshkrim të Xhuzepe Anxhelo Noçiti*. Legato a questo contributo, mi è gradito dare la notizia che fra breve darò alle stampe il suo *Vocabolario albanese* che raccoglie più di 10.000 lemmi. Una personalità ricca di interessi e di studi, come quella del Nociti, non poteva rimanere ignota al mondo della cultura e della letteratura albanese.

Sempre sulla linea della pubblicazione dell'inedito della letteratura arbëreshe si muovono gli altri lavori che interessano le opere di un grande scrittore dell'Ottocento: Francesco Antonio Santori. La pubblicazione di alcune novelle in versi mi hanno dato lo spunto per sottolineare la novità della sua creazione letteraria: l'interesse per il sociale e l'inaugurazione della letteratura impegnata. Così anche la pubblicazione delle sue *Kalimere* (Brenner, Cosenza, 2004) sono il segno della dimensione che la componente religiosa ha avuto per la spiritualità bizantina delle comunità arbëreshe e per il rafforzamento dell'identità culturale.

Anche da questi brevi cenni si può dedurre come la cultura arbëreshe dal Dopoguerra ad oggi si vada irrobustendo nelle sue ricerche scientifiche, che poi vengono calate negli ambiti più diffusi ed estesi per permeare tutta la componente comunitaria.

Qual è lo stato attuale della lingua, della letteratura e della cultura arbëreshe?

Se confrontiamo lo stato attuale della lingua parlata nelle comunità arbëreshe dell'Italia meridionale con il passato, constatiamo che si è verificato una diminuzione statistica dei parlanti arbërisht soprattutto presso le nuove generazioni. La trasmissione della lingua parlata in famiglia e nel paese si è indebolita a favore dell'italiano. Si spera in una ripresa quando l'insegnamento scolastico dell'arbërisht sarà più incisivo e meglio organizzato, in modo da sopperire alla diminuzione di incidenza nella trasmissione della lingua che prima avveniva soprattutto a livello di famiglia e di comunità nel suo complesso. La creazione letteraria, invece, dal Dopoguerra ad oggi sta vivendo una stagione fiorente, con un numero di autori che va arricchendosi di continuo. Accanto a poeti del livello di Vorea Ujko, di Dushko Vetmo, di Giuseppe Schirò di Maggio, si va affermando una pleiade di voci nuove che scrivono tanto in poesia che in prosa. E' significativo che esista una rivista da circa dieci anni che è scritta interamente in albanese: *Jeta arbëreshe*, in cui scrivono tanto arbëreshë nelle varie parlate, quanto shqiptarë nella lingua standard ma su argomenti arbëreshë.

Ritengo che negli ultimi decenni si sia allargata la cerchia di chi sappia scrivere nella propria lingua materna, sia per l'effetto del risveglio generale per le culture minoritarie esistenti sul territorio italiano, che sempre più vengono considerate come una vera ricchezza nazionale, e sia per la Legge 482 approvata dal Parlamento italiano nel 1999 che tutela queste minoranze.

Tuttavia, nonostante questo risveglio dell'interesse, la salute della cultura arbëreshe non è buona: la pressione esercitata dalla cultura dominante, quella italiana, sta assorbendo la cultura minoritaria arbëreshe. Il vento delle trasformazioni e dei contatti sempre più veloci tra elemento italiano e elemento arbëresh soffiava con violenza e tende a spazzare via le identità locali.

Sembra che ci troviamo di fronte a due fenomeni contrapposti: il primo è una tendenza appannaggio di una élite di intellettuali e di appassionati che si dedicano con impegno e dedizione alla valorizzazione della cultura materna dei vari paesi arbëreshë; il secondo è rappresentato dall'avanzamento massiccio della cultura italiana che disgrega, assorbendola, quella arbëreshe, che non possiede gli strumenti adatti per uno sviluppo istituzionale, organico e sistematico. Venendo meno la trasmissione tradizionale della

cultura arbëreshe che, in passato avveniva attraverso la famiglia e la piazza o la comunità, se non si provvederà a sostituirla con l'istruzione istituzionalizzata e obbligatoria, con le stesse prerogative della cultura dominante italiana, si rischia un continuo indebolimento fino alla scomparsa.

Quali prospettive, dunque, intravede per la lingua e la cultura arbëreshe?

Nonostante la comprensibile difficoltà in cui si trova la lingua e la cultura arbëreshe di fronte all'azione di assorbimento che opera la lingua e la cultura italiane da una posizione dominante, sono convinto che molto si può fare con prospettive positive che garantiranno la loro continuità.

Il ruolo principale oggi lo deve svolgere la **scuola**, perché la cultura arbëreshe da cultura analfabeta diventi cultura scritta da tutti i membri della comunità. Oggi esiste la legge di tutela delle minoranze linguistiche storiche esistenti sul territorio italiano, ebbene questa legge deve essere migliorata al fine di rendere obbligatorio l'insegnamento della lingua della letteratura e della cultura arbëreshe nella scuola dell'obbligo: è un dovere dello stato italiano insegnare a scrivere ai bambini la lingua dei propri genitori. Un esempio: nel 1867 dei 300.000 cittadini della popolazione *maori* della Nuova Zelanda solo un quarto usava la propria lingua indigena, tutti gli altri parlavano inglese. Con l'istituzione massiccia di scuole che insegnavano il loro idioma, prima di tutto "i nidi di lingua", per i più piccini, e poi la scuola elementare e media di primo grado, alla fine del secolo raggiunsero un obiettivo soddisfacente: la gran parte dei *maori* era alfabetizzata nella propria lingua e cultura. Oggi nella Nuova Zelanda il maori è l'unica lingua indigena che continua ad essere parlata.

Altro punto importante è il **coinvolgimento** dei parlanti arbërisht nel processo di rivitalizzazione della propria cultura. Va operata una forma di sensibilizzazione delle famiglie e dell'intera comunità con un impegno spontaneo e convinto a favore della lingua materna che oggi è minacciata. Questo coinvolgimento deve avere come obiettivo la convinzione che l'uso dell'arbërisht non danneggia i parlanti in nessun modo, anzi li privilegia, perché li fa crescere e sviluppare armonicamente con la cultura di base e li facilita nell'apprendimento di altri codici linguistici (inglese, francese, tedesco...).

Un ruolo altrettanto importante nella difesa delle lingue deboli lo svolgono i **linguisti** o più genericamente gli **studiosi**. Essi hanno il compito di studiare scientificamente le parlate, in questo caso, quelle arbëreshe, farne la descrizione e arrivare a formulare strumenti didattici utili per tutti i parlanti. Molto è stato fatto negli ultimi anni. Cito solo alcuni testi: *La parlata albanese di Greci*, fatta da M. Camaj (Firenze 1971), *Arbërishtja për të gjithë* di Giuseppe Schirò Di Modica (Piana Degli Albanesi 2005), *Gramatikë arbëreshe* di Emanuele Giordano (2005), e il manuale in due volumi destinato alle scuole *Alfabetizzazione arbëreshe* (Ed. Il Capitello, Torino 2000), compilato da una équipe di studiosi (C. Stamile, A. Giodano, V. Bruno, I. C. Fortino, E. Tocci, E. Giordano) e promosso dall'Associazione Insegnanti Albanesi d'Italia.

Un fenomeno interessante si è verificato negli ultimi anni: la lingua arbëreshe, che è stata considerata solo lingua delle comunicazioni familiari e popolari, viene utilizzata, da alcuni pionieri, anche nelle conferenze e nei convegni, ossia nelle comunicazioni più impegnative e di prestigio che si tengono nei paesi arbëreshë. Ciò concorre a dare prestigio alla lingua arbëreshe e la mette alla prova per esprimere concetti astratti e impegnativi.

In conclusione ritengo che se vengono presi provvedimenti nella linea che ho indicato, la lingua e la cultura arbëreshe hanno buone prospettive di resistenza al pericolo della scomparsa e possibilità di reale sviluppo, in quanto rappresentano una vera ricchezza dell'intero stato italiano in cui sono inserite.